



# STIKK

SHOQATA PËR TEKNOLOGJI TË INFORMACIONIT  
DHE TË KOMUNIKIMIT TË KOSOVËS

KOSOVO ASSOCIATION OF INFORMATION  
AND COMMUNICATION TECHNOLOGY

# Ekosistemi Funksional për Bizneset e Reja

Përkrahja që çon peshë për  
prurjet e reja në sektorin e  
TIK

**DOKUMENT POLITIKASH**

përgatitur nga Kushtrim Shaipi (IQ Consulting)

Prishtinë, Nëntor 2014

Mbështetur nga:

**spark**  
*ignites ambition*

## Përmbajtja

Përmbajtja .....	2
Shkurtesat .....	3
1. Sfondi .....	4
1.1. Qëllimet.....	4
1.2. Situata Aktuale .....	4
1.3. Të Arriturat dhe Praktikrat më të Mira .....	6
1.4. Barrierat dhe Sfidat Kryesore për Ekosistemin e Startup-eve në Kosovë .....	6
2. Perspektiva e Bizneseve të Reja: Rasti që duhet Përkrahur .....	7
3. Rekomandimet për Politika .....	8
4. Pikat Kyçe të Intervenimit .....	9
4.1. Qeveria e Kosovës: MEF / MZHE & MTI .....	9
4.2. Shoqata e TIK .....	10

## Shkurtesat

<b>ATK</b>	Administrata Tatimore e Kosovës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>ICK</b>	Innovation Centre Kosovo
<b>JIC</b>	Jakova Innovation Center
<b>MEF</b>	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
<b>MTI</b>	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
<b>MZHE</b>	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
<b>STIKK</b>	Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës
<b>TIK</b>	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
<b>BB</b>	Banka Botërore

# 1. Sfondi

## 1.1. Qëllimet

Ky aktivitet i ofron ndihmë STIKK-ut (Shoqata e Kosovës për Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit) për të shqyrtuar në tërësi klimën e përgjithshme për bizneset e reja dhe përfitimet e mundshme që vijnë nga mundësia e një ekosistemi të qëndrueshëm për startup-e në Kosovë. Për qëllimet e këtij dokumenti, një ekosistem për startup-e duhet kuptuar si një konstelacion njerëzish, i kompanive të reja si dhe lloje të ndryshme të organizatave në një vend (fizik ose virtual) që ndërveprojnë si një sistem për zhvillim dhe krijimin e kompanive të reja. Mbështetja fillestare për gjenerimin e planeve të biznesit që janë financiarisht të qëndrueshme dhe modele të zbatueshme nga idetë e para krijuese, është zakonisht ajo që e bën dallimet në mes të përpjekjeve të suksesshme dhe atyre që dështojnë. Ky vlerësim qëndron veçanërisht vlen për kompanitë e reja të TIK që zakonisht iniciohen nga individë ose grupe entuziastësh të teknologjisë të cilëve u mungon arsimimi në ndërmarrësi si dhe arsimit formal për menaxhim të biznesit.

Shërbimet mbështetëse të ofruara në ambient të favorshëm qoftë nga entitete komerciale apo nga qendrat jo-fitimprurëse (OJQ) shpesh janë treguar të jenë jetike për t'i rritur gjasat e bizneseve për mbijetesë përmes strukturimit të ideve të tyre, por edhe përmes sigurimit të ekspertizës në zbatimin e aspekteve të ndryshme të projekteve të tyre. Nëse konsiderohet mosha relativisht e re që kanë sipërmarrësit në sektorin e TIK, e cila është më e ulët se në çdo sektor tjetër, mbështetja e strukturuar përmes trajnimit, infrastrukturës dhe shërbimeve, bëhet e domosdoshme. Pasi kompanitë e reja të teknologjisë me rritje të shpejtë janë konsideruar të jenë motori kryesor i rritjes ekonomike për shoqëritë e zhvilluara të bazuara në informacion, ekosistemet për përkrahjen e bizneseve të reja që kanë përjetuar një zhvillim të hovshëm, me siguri do të skicojnë të ardhmen e ekonomisë botërore.

Në një kornizë të tillë, STIKK ka angazhuar IQ Consulting për të hartuar këtë punim që synon eksplorimin e mundësive për sigurimin e mbështetjes për bizneset e reja në sektorin e TIK, duke i rritur kështu gjasat e suksesit për të sapoardhurit në treg. Nëse konsiderohet situatë aktuale ekonomike në Kosovë, dhe shkalla e lartë e papunësisë, sukcesi i iniciativave sipërmarrëse përkthehet si zbutje e të dy këtyre aspekteve. Ky dokument ka për qëllim të sjellë vëmendjen e aktorëve dhe vendimmarrësve relevant tek mundësitë e paraqitura në mjedisin aktual të biznesit që do të lehtësonin evoluimin e suksesshëm të bizneseve të reja në sektorin e TIK. Ky punim synon një audience të gjerë që përfshin STIKK, ICK, Qendra për Inovacion Jakova, ministrat përkatës të linjës, si dhe organizatat e mëdha donatore qofshin nga programe bilaterale apo multilaterale.

## 1.2. Situata Aktuale


Sektori i TIK në Kosovë karakterizohet nga një numër i madh i kompanive të vogla dhe të mesme me kapacitete të kufizuara për projekte dhe iniciativa të mëdha. Për shkak të madhësisë relativisht të vogël të tregut, kompanitë që janë rritur përtej konkurrueshmërisë kanë qenë të detyruara për të ndajné një pjesë të aktiviteteve të tyre në ndërmarrje të reja në mënyrë që të mbajnë leadershipin në treg. Përbërja e tillë e sektorit ofron kushte mjaft të favorshme për hyrje në treg për kompanitë e reja.

Procedurat ekzistuese të regjistrimit dhe licencimit të parapara në ligjet e aplikueshme nuk paraqesin pengesa për hyrjen e kompanive të reja, pavarësisht sektorit. Procedurat e regjistrimit

të kompanisë mund të përfundohen brenda një ditë pune dhe procesi i regjistrimit të biznesit është pa asnjë kosto. Asnjë barrierë sistematike/rregullative përveç atyre që lidhen me zbatimin më efikas të të drejtave të pronësisë intelektuale nuk është identifikuar gjatë këtij studimi. Duke pasur parasysh natyrën e sektorit të TIK dhe kostot relativisht të ulëta fillestare të investimit për shumicën e bizneseve fillestare të këtij sektori, fokusi duhet të vendoset në sigurimin e mbështetjes sistematike si dhe asaj ad-hoc për to, si 'përbërësi' që ka nevojë për më shumë vëmendje.

Ndërsa ka vetëm dy organizata<sup>1</sup> dhe një program<sup>2</sup> që ofrojnë përkrahje për kompani fillestare të TIK, ekzistojnë edhe iniciativa të tjera<sup>3</sup> që kanë filluar të zhvillohen. Programe të tjera të përgjithshme të përkrahjes për biznese fillestare të financuara nga organizata donatore<sup>4</sup> janë duke u zbatuar apo presin vazhdimin në të ardhmen e afërt. Këto programe të përgjithshme kanë qenë jetike për disa biznese fillestare (përfshirë TIK) duke ju dhënë atyre fondet për të materializuar idetë e tyre si dhe aftësi themelore në menaxhimin e biznesit dhe / ose ndërmarrësi. Mirëpo, kohëzgjatja e kufizuar e tyre programeve ka qenë një pengesë kyçe që ka zbehur suksesin nga këto ndërhyrjeve një-herëshe.

Ndërsa 'përbërësit' e nevojshëm për një ekosistem për biznese fillestare ekzistojnë në Kosovë, në vazhdimësi ka munguar një qasje sistematike për të ndërlidhur ata të funksionojnë si një ekosistem në mbështetje të inovacionit dhe sipërmarrjes. Ndonëse ka inkubatorë (si fizik ashtu edhe virtual), ofruer të trajnimeve, shërbime mbështetëse profesionale që vihen në dispozicion për biznese fillestare, 'sezonaliteti' i financimit i cili varet nga programet e donatorëve, ka qenë një pengesë e madhe në funksionimin e ekosistemit. Përveç kësaj, mungesa e fondeve të përhershme për kërkime dhe inovacion gjithashtu është identifikuar të jetë një pengesë serioze për një ekosistem të përshtatshëm. Përvoja ka treguar se shërbimet sistematike, mbështetja dhe trajnimi për biznese fillestare të TIK që marrin financim për të materializuar idetë e tyre të biznesit janë jetike për të rritur shkallën e mbijetesës së tyre. Situata aktuale me ekosistemin për biznese fillestare është paraqitur në figurën më poshtë.



<sup>1</sup> Innovation Centre Kosova dhe Jakova Innovation Center

<sup>2</sup> UNICEF Innovation Lab

<sup>3</sup> Siç është Prishtina Hackers Space

<sup>4</sup> Programet e BE-së, Projekti EYE si dhe EYE përkrahja për startup-e, Programi për Zhvillim të Rinisë i Bankës Botërore, Projekti SILED i BB, etj.

### **1.3. Të Arriturat dhe Praktikrat më të Mira**

Kjo pjesë e analizës kalon nëpër mësimet e nxjerra dhe praktikrat më të mira të cilat janë zbatuar në Kosovë dhe në vende të tjera me mjedise të ngjashme. Këtu, gjithashtu shqyrtohen sfidat kryesore me të cilat përballen akterët ekzistuese në ekosistem, dhe shqyrtohen mundësitë për të adresuar më së miri këto sfida. Ndërsa të gjithë 'përbërësit' për një ekosistem të bizneseve fillestare ekzistojnë në Kosovë, dhe të gjithë akterët relevantë janë të pranishëm, mungesa e ndërlidhjes midis akterëve në një sistem të sinkronizuar mirë është identifikuar si mangësia kryesore për të rritur performancën e sektorit në stimulimin e bizneseve të reja.

Innovation Centre Kosovo, Jakova Innovation Center dhe inkubatorët e tjerë të biznesit ose kuazi inkubatorët sjellin përvoja dhe njohuri shumë të vlefshme si dhe paraqesin një gurë-themel të fortë të ofrimit të mbështetjes për biznese të reja në Kosovë. Disa nga praktikrat e mira të aplikuara deri më tani përfshijnë ndër të tjera sigurimin e shërbimeve virtuale, që ka bërë të mundshëm shërbimin e kompanive fillestare edhe jashtë vendndodhjes fizike të qendrës. Mbështetja përmes mundësimin të shërbimeve dhe burimeve online është një qasje me kosto të ulët që është dëshmuar të jetë e efektshme në arritjen e qëllimeve të saj.

Pjesëmarrja në nismat rajonale dhe globale si dhe rrjetëzimi me organizata të karakterit të ngjashëm për të krijuar një mjedis global për kompani fillestare duhet të vazhdojë si një atribut i rëndësishëm i inkubatorëve të TIK.

### **1.4. Barrierat dhe Sfidat Kryesore për Ekosistemin e Startup-eve në Kosovë**

Koordinimi në mes të akterëve për të mundësuar funksionimin adekuat të ekosistemit është një nga prioritetet më të mëdha për përmirësimin e mjedisit për bizneset e reja. Mungesa e një ministrie të veçantë të qeverisë dedikuar inovacionit dhe sipërmarrjes është identifikuar si një nga mangësitë më të mëdha në funksionimin e ekosistemit. Një ministri me mandat të tillë do të ishte në gjendje të koordinojë të gjithë akterët e ekosistemit dhe do të çonte drejt një sinergjie më të madhe në punën e tyre. Në mungesë të një ministrie të tillë, shoqata sektoriale STIKK, përkundër sfidave me të cilat mund të ballafaqohet, duhet të angazhohet më intensivisht për koordinimin e akterëve dhe bashkëpunim.

Financimi i vazhdueshëm për aktivitetet bazë të akterëve kryesorë është gjithashtu një nga sfidat më të mëdha për ekosistemin stabil dhe të qëndrueshëm për biznese fillestare në Kosovë. Varësia e akterëve kyç në ekosistem nga financimet e donatorëve ndërkombëtarë paraqet një nga rreziqet më të mëdha për një mjedis që favorizon bizneset. STIKK si e vetmja shoqatë sektoriale dhe ICK si një nga modelet më të mira të inkubatorëve për TIK janë të varur nga disponueshmëria e fondeve të donatorëve, e cila e bën planifikimi afatgjatë dhe zhvillimin e burimeve shumë të vështirë.

Mungesa e fondeve paraqet është gjithashtu një nga sfidat më të mëdha për startup-e në Kosovë, pasi që nuk ka kanale komerciale apo publike përmes të cilave ata do të mund të qaseshin në financa për të investuar në idetë e tyre të biznesit. Përderisa programet dhe projektet e financuar nga donatorët kanë dhënë periodikisht fonde fillestare për biznese të reja, mungesa e programeve të përhershme të financimit për to është një sfidë e madhe që duhet adresuar.

Mungesa e programeve të financimit gjithashtu paraqet një sfidë të madhe për zhvillimin e veprimtarive kërkimore, të cilat përfaqësojnë një nga katalizatorët më të mëdhenj të inovacionit

dhe zhvillimit të produkteve/shërbimeve të reja. Mungesa e programeve për financim të hulumtimeve si akademike ashtu edhe aplikative është identifikuar si një përbërës kyç që aktualisht mungon për nxitjen e krijimit të bizneseve të reja. Përderisa ka kompani dhe organizata që kryejnë kërkime të shumta në Kosovë, ata në përgjithësi i kryejnë ato me porosi që zakonisht i dedikohet një audience të kufizuar. Hulumtimet e besueshme, dhe në veçanti, hulumtimet akademikisht relevante janë shumë të rralla në Kosovë dhe bizneset e reja nuk kanë fare qasje në to.

## **2. Perspektiva e Bizneseve të Reja: Rasti që duhet Përkrahur**

Ekonomia mund të mbahet konkurruese vetëm me shpikjen dhe ri-shpikjen e produkteve dhe shërbimeve dhe nëpërmjet prurjeve të qëndrueshme të konkurrentëve të rinj me ambicie për t'u bërë udhëheqës në tregjet e tyre përkatëse. Numri i ndërmarrjeve / bizneseve të reja është përdorur shpesh si një tregues për të matur shëndetin dhe performancën e ekonomive.

Përderisa mjedisi i përgjithshëm i të bërit biznes në Kosovë është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme në vitet e fundit<sup>5</sup>, dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore për të filluar një biznes brenda dy ditëve të punës, mungesa e mbështetjes financiare në fazën fillestare të bizneseve, ka qenë një pengesë e 'padukshme' që ka penguar krijimin e sipërmarrjeve të reja.

Përkrahja ndaj sipërmarrjeve premtuese të biznesit mund të krahasohet me përkrahjen ndaj të sapolindurve derisa ata të janë në gjendje të kujdesen për veten, madje edhe të kujdesen një ditë edhe për të tjerët. Ngjashëm me shoqërinë, tregu ka nevojë edhe për prurje të vazhdueshme të konkurrentëve të rinj në mënyrë që të mbetet gjallë, konkurrues dhe i qëndrueshëm. Për të mbajtur 'natalitetin' e bizneseve të lartë, një mjedis i përshtatshëm duhet të krijohet për të 'sapolindurit' në treg. Dy vitet e para në jetën e bizneseve janë më të vështirat për t'u kapërcyer, dhe për shumicën e bizneseve të reja shënuar vijën ndarëse në mes të brishtësisë dhe veprimtarisë së themeluar. Në hapat e tyre të parë, bizneset kanë nevojë për mbështetje financiare, shërbime, qasje në burime, dhe përvojë (know-how), si dhe një treg për produktin e tyre, në mënyrë që të kapërcejnë pragun e mbijetesës dhe të vendosin prani afatgjatë në treg. Edhe pse këto shërbime janë të qasshme në treg, bizneset fillestare nuk janë në gjendje t'i përballojnë këto shërbime nga ofrues komercial.

Arsyeshmëria financiare për mbështetjen e bizneseve fillestare në fushën e TIK është gjithashtu shumë e shëndoshë. Duke pasur parasysh potencialin për biznes nëpërmjet internetit që është duke u rritur shumë shpejt, tregu për bizneset e TIK është asgjë më pak se sa global. Nëse vetëm një nga 1,000 bizneset e mbështetur bëhet një biznes global i suksesshëm, vlera e shtuar nga ajo kompani tejkalon koston e investimit në 1,000 kompani fillestare për shumë here.

Një pjesë e mirë e bizneseve të TIK mund të fillohen me sukses për më pak se 10,000€, mirëpo kjo kosto është e pamundur për të mbuluar për shumicën e ndërmarrësve të rinj në Kosovë. Në mungesë të punësimit me orar të plotë, pasurisë së paluajtshme, apo të ardhura të dokumentuara, ata nuk kanë qasje në tregun komercial financiar. Lidhjet e forta farefisnore dhe familjare që ende mbeten mjaft me ndikim në Kosovë kanë qenë shumë të rëndësishme për të mbuluar deri në një masë pengesat që rrjedhin nga mungesa e financimit për biznese të reja. Tek një numër i konsiderueshëm i bizneseve të reja, financimi fillestar vjen nga familja me perspektivën e një biznesi të ri familjar, ose thjesht nëpërmjet mbështetjes me të holla personin

---

<sup>5</sup> World Bank "Doing Business Reports" dhe raporte të tjera monitoruese tregojnë përmirësimin e dukshëm në vitet e kaluara. Më shumë informata mund t'i gjeni në: <http://www.doingbusiness.org/>

që ka ndërmarrë përpjekjen. Mbështetja përmes ofrimit të pajisjeve, sidomos nga familjarë në diasporë, ka qenë gjithashtu një element i rëndësishëm për fillimin e shumë bizneseve të TIK.

Një karakteristikë e rëndësishme e bizneseve të reja në Kosovë është gjithashtu se moshë mesatare e sipërmarrësve është shumë më e ulët se sa moshë mesatare në vendet e tjera. Ndërkohë që kjo ka qenë kryesisht për shkak të demografisë së popullsisë, në bazë të së cilës Kosova rangohet si vendi me popullatën më të re në Evropë, ajo gjithashtu ka pasur një ndikim në shkallën e suksesit të bizneseve të reja. Shpesh ndodhë që sipërmarrës të rinj të talentuar të lënë idetë e tyre të biznesit në këmbim të punësimit me pagë në kompanitë ekzistuese. Në mungesë të financimit për fazën e zhvillimit, ata i kthejnë në punësim të plotë për plotësimin e nevojave të tyre të ardhurave. Investimi në biznese të reja, për këtë arsye mund të konsiderohet edhe një investim i shëndoshë në zhvillimin e të rinjve dhe investim që ata të ndjekin ëndrrat e tyre dhe për të arritur vetë-realizimin në një mjedis që nuk ju ofron atyre shumë mundësi.

### **3. Rekomandimet për Politika**

Qeveria duhet të marrë një rol më të madh në koordinimin e organizatave donatore ndërkombëtare që ofrojnë për financim fillestar për biznese të reja. Në vend të skemave periodike të granteve të publikuara nga donatorë individualë që aplikojnë kritere të ndryshueshme, organizatat donatore duhet të nxiten të bashkojnë fondet e tyre në një skemë publike të financimit që financon bizneset e reja sipas planeve dhe strategjive për zhvillimin sektorial dhe kombëtar. Një qasje e tillë do të lejonte një qëndrueshmëri më të madhe të skemave të financimit dhe disponueshmërinë më të madhe të financimit për këto biznese. Një fond i tillë do të mund të menaxhohej nga Ministria e Inovacionit që pritet të krijohet nga koalicioni i ri qeverisës, apo t'i besohet ndërmjetësve sektorial si STIKK dhe ICK, si ndër akterët më të përshtatshëm për një asistencë të tillë.

Pasi që shumë biznese të reja kërkojnë programim/kodim si pjesë e zhvillimit fillestar të biznesit, do të duhej të krijohen skema mbështetëse që do të mbulonin koston e zhvillimit (programuesve). Skema të tilla ndoshta do të mund të mbështesnin idetë e biznesit që janë aktualisht të lëna anash për shkak të pamundësisë për të financuar fazën e zhvillimit. Si i tillë, financimi për kërkime dhe zhvillim do të duhej të inkurajonte zhvilluesit entuziastë që të ndërtojnë së paku modelet demonstruese që mund të ju sjellin atyre financim komercial. Një gjë e tillë do të rriste mundësinë që bizneset fillestare TIK me rritje të shpejtë të pranojnë financim në fazat e hershme të zhvillimit.

Trajnim formal në nivele më të larta duhet të mbahet i përditësuar dhe të bazohet në kërkesën e tregut për aftësi dhe kompetenca. Ndërsa burimet elektronike të të mësuarit në dispozicion për biznese fillestare në TIK janë të shumta, trajnimi formal dhe arsimiti shpesh është kritikuar për dështimin për të furnizuar punonjës me cilësi të lartë në treg. Në këtë kontekst, rishikimi i kurrikulës në sistemin e arsimit publik për përditësimin informacionit të paraqitur në të, si dhe përfshirja e lëndës së nërmarrësisë në nivelet e hershme të arsimit, janë të disa nga konsideratat kryesore që duhet të merrem parasysh. Përveç kësaj, përmirësimet në sistemin e arsimit në të gjitha nivelet duhet të përfshijë ndërhyrje për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në matematikë dhe shkenca natyrore si lëndët kryesore për zhvillimin e TIK. Për këtë qëllim, aktivitetet jashtë-shkollore si klube të shkencës, panairë dhe konkurse për shkolla fillore dhe të mesme do të duhej të organizohen për të promovuar angazhimin në shkencë. Në nivelet më të larta të arsimit, praktikat e tilla do të duhej të intensifikohen për të promovuar konkurrencën e ideve dhe inovacionit.



Ndërlidhjet midis botës akademike dhe sektorit privat duhet të forcohet. Aktualisht, këto dy grupe të akterëve rrallë bashkëveprojnë pavarësisht ndërlidhshmërisë së tyre në aspektin e funksionit. Ndërsa akterët akademik në Kosovë kanë marrë kryesisht rolin e mësimdhënies, duke i kushtuar kështu shumë pak kohë përpjekjeve kërkimore dhe të inovacionit, sektori privat ka qenë joefikas për të shprehur pikëpamjet e tyre në lidhje me sistemin e arsimit dhe rezultatet që i njëjti prodhon. Një nga modelet më efikase për lehtësimin e ndërveprimit të tillë dhe adresimin e mangësive ekzistuese është krijimi i programeve që financojnë kërkime aplikative akademike në sektorin privat, ku, dy akterët do të zhvillojnë dhe zbatonin bashkërisht projekte, duke krijuar kështu lidhjen e humbur në mes të dy palëve, që mund të zgjerohet edhe në aktivitete të tjera. Sërish, aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit do të duhej të përkrahen nga skema publike të financimit që kontribuojnë në krijimin e një ambient mundësues për krijimin e liderëve në tregjet lokale dhe ndërkombëtare.

## 4. Pikat Kyçe të Intervenimit

### 4.1. Qeveria e Kosovës: MEF / MZHE & MTI

Themelimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë është një mangësi serioze në organizimin sektorial të Qeverisë. Mungesa e një ministrie me mandat për të koordinuar akterët përkatës në çlirimin e potencialit inovativ të bizneseve dhe ndërmarrësve të Kosovës ka penguar në masë të madhe përpjekjet e kaluara të akterëve individualë në ekosistem. Koordinimet e shumta ndër-sektoriale të nevojshme për të lehtësuar në mënyrë efektive funksionimin e ekosistemit janë të pamundura pa një bartës kryesor të rolit udhëheqës në proces. Zotimi elektoral i partive politike në koalicionin qeverisës ka qenë adresimi i kësaj sfide përmes një ministrie të re dedikuar teknologjisë dhe inovacionit. Akterët kyç, me interes të madh në këtë çështje, (p.sh. STKK dhe ICK) duhet të mbajnë qeverinë të përgjegjshme ndaj premtimeve të dhëna dhe të avokojnë për zbatimin e tyre.

Financimi për biznese të reja është inekzistent në Kosovë. Përveç skemave periodike të granteve të menaxhuara nga organizatat donatore që financojnë bizneset e reja, nuk ka programe / fonde të përhershme, që investojnë në këtë kategori të bizneseve. Ndërsa ka pasur programe të shumta të financuara nga donatorët që kanë dhënë mbështetje financiare për bizneset e reja, ndikimi që kanë pasur në ngritjen e tyre ka qenë i kufizuar. Modelet më të suksesshme duket të jenë ato që kombinojnë fondet fillestare me asistencë teknike dhe zhvillimin e kapaciteteve për periudha më të gjata kohore. Programet e kohëpaskohëshme të financimit që vetëm shpërndajnë fonde për personat me ide të biznesit, rrallë gjenerojë ndikimin e dëshiruar. Për këtë arsye duhet të krijohen paketa të përhershme stimulimi për biznese të reja.

Paketa stimuluese financiare duhet gjithashtu të ofrohen për bizneset e reja premtuese. Kuadri ligjor duhet të ndryshohet për të siguruar lirim të plotë nga tatimet për një kohëzgjatje të kufizuar për biznese të reja. Këto potencialisht mund të përfshijnë tatimin mbi të ardhura, tatimin në fitimit dhe TVSH. Përveç kësaj, skemat publike që pjesërisht mbështesin edhe pagat për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të TIK, gjithashtu duhet të merren parasysh.<sup>6</sup>

---

<sup>6</sup> Shih gjithashtu analizën e STIKK: Çlirimi i Potencialit Eksportues të Kompanive Kosovare të TIK: Qasje e Strukturuar për Promovim sektorial të Eksporteve

## **4.2. Shoqata e TIK**

STIKK duhet të vazhdojë me marrjen e përgjegjësive të përcaktuara për të në Strategjinë Kombëtare për TIK, si dhe, barrën e përfaqësimit të interesave kolektive të sektorit. STIKK-ut i takon të ndjekë rekomandimet e politikave të dala nga ky punim dhe të avokojë për zbatimin e tyre nga akterët relevant.

Përveç kësaj, STIKK duhet të propozojnë modele për koordinimin e palëve të interesuara për funksionalizimin e duhur të ekosistemit për biznese të reja, dhe të avokojë intenzivisht për krijimin e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

Konkurse vjetore / periodike, programe shkëmbimi, rrjetëzim me programe të tjera të ngjashme jashtë vendit duhet të përdoret për të promovuar dhe për të nxitur inovacionin e biznesit.

Ngjarje dhe programe të rregullta duhet të zhvillohen për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin. Konkurse vjetore / periodike, programe shkëmbimi, rrjetëzim me programe të tjera të ngjashme jashtë vendit gjithashtu duhet të përdoren për të promovuar dhe për të nxitur inovacionin tek bizneset.

Rr. Rexhep Mala, 28A  
10000 Prishtine, Republika e Kosoves  
Tel. +381 38 77 11 80 ext. 501

[info@stikk-ks.org](mailto:info@stikk-ks.org), [www.stikk-ks.org](http://www.stikk-ks.org)



[/STIKK.Official](https://www.facebook.com/STIKK.Official)



[/STIKK\\_Ks](https://twitter.com/STIKK_Ks)



[/company/STIKK](https://www.linkedin.com/company/STIKK)